

VENDIM
Nr.560, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.768, DATË 12.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË AFËRSI TË MALIQIT DHE RRUGËS HYRËSE, QARKU KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.768, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet lista sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
- b) Në pikën 3 të vendimit, sipërfaqja ndryshohet, nga 149 596 (njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², në 150 469 (njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m².
- c) Në pikat 3 dhe 4 të vendimit, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve ndryshohet, nga 36 021 456 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, në 36 206 532 (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Vlera prej 185 076 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh do të përballohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Menaxhim i mbetjeve urbane", për vitin 2019.

3. Shpenzimet procedurale, me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të Qarkut Korçë, KRWM", Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-NË NR. 768, DATË 12.11.2014 "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË AFËRSI TË MALIQIT DHE RRUGËS HYRËSE", QARKU KORÇË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale m ²	Sipërfaqja e prekur nga shpronësimi m ²	Tokë arë çmimi lekë/m ²	Vlera totale	Shënime
1	Lirije	Nexhat	Tili	1667	20/73	arë	873	873	212	185,076	Konfirmuar nga ZRPP, më datë 15.12.2015
Vlera totale										185,076	

Shënim 1. Për vlerësimin e pasurisë të llojit "tokë arë", çmimi për njësi i është referuar çmimit të vendosur në VKM nr. 768, datë 12.11.2014